



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 13.07.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 9,10 dhe 29.2 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, pas shqyrtimit të kërkesës së z. Arber Zeka për mbështetje financiare me subvencione komunale për riparimin, e banesës në pronësi komunale të cilën e shfrytëzon për strehimin e familjes së tij dhe njoftimit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për mungesë të mjeteve të subvencioneve të kësaj drejtorie, me dt: 13.07.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e z. Arber Zeka nga Gjakova nr. 05-400-22421 e dt:20.03.2015 për ndihmë financiare për renovimin e banesës në pronësi komunale të cilën ai e shfrytëzon për strehimin e familjes së tij, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 1,000.00€ .

2.Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të zotoj mjetet financiare në vlerë prej 1,000.00€, nga pozicioni i subvencioneve të Zyrës së Kryetares së Komunës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e z.Arber Zeka nga Gjakova nr. 2011000054176092 Teb Bank .

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Z. Arber Zeka , Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari- Lila